



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 28/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) - KQZ, për tërheqjen e ankesës së parashtruar ndaj Hysni Rexhepit nga fshati Klinë e Mesme komuna e Skenderaj, kandidat i pavarur për Zgjedhjet Lokale 2013 në seancën e panelit të mbajtur me 12.03.2014, mori këtë:

### V E N D I M

**Konstatohet e tërhequr ankesa** që ka të bëjë me Hysni Rexhepin, kandidat i pavarur për Zgjedhjet Lokale 2013, të parashtruara në PZAP nga Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) - KQZ.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar nga ZRPPC-ja një kërkesë për tërheqjen e ankesës të parashtruar në PZAP kundër Hysni Rexhepit, kandidat i pavarur për Zgjedhjet Lokale 2013, në të cilën kërkohet që të tërhiqet nga shqyrtimi ankesa e lartpërmendur pasi që kandidati në fjalë e ka dorëzuar raportin financiar të shpenzimit të fushatës zgjedhore. PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqje e ankesës së sipërshënuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos te shqyrtohet pjesa që ka të bëjë me kandidatin në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 28/2014 më datën 12.03.2014

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha

